



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)

Univerzitetske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)

Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)

Qendra Klinike Universitare e Kosovës - Universitetski Klinicki Centar Kosova -

University Clinical Center of Kosova

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
SHËRBIMI SPITALOR DHE KLINIKË UNIVERSITAR I KOSOVËS -
UNIVERSITETSKJE BOLNIČKE I KLINIČKE SLUŽBE KOSOVA -
THE HOSPITAL AND UNIVERSITY CLINICAL SERVICE OF KOSOVO
ARKIVI QENDROR - CENTRALNI ARHIV - CENTRAL ARCHIVE

Nr. i njesis org
org.jed
org.unit
Nr. i faq.
Broj. prot.
Prot. no.
Data
Datum
Date

9777
07.11.25



Në bazë të nenit 79, nenit 80, 81 dhe 96, neni 97 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Rregullore Nr. 30/2024 për Procedurën e Pranimit të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e shëndetësisë dhe Rregulloren (QRK) Nr. 27/2024 për Procedurat e konkurrimit për nëpunës teknik dhe mbështetës, nenit 18 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, Sektorit i Personelit të QKUK-së, publikon:

KONKURS PUBLIK

Institucioni: Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK)

Nr.i Referencës: QKUK 10/2025-11/171

Nr	Pozita	Klinika	Kohëzgjatja e kontratës së punës	Klasa	Numri i kërkuar
1	Mjek specialist	Psikiatria	Kohë të pacaktuar	H8	2
2	Mjek specialist	Kirurgjia Vaskulare	Kohë të pacaktuar	H8	1
3	Mjek specialist i Mikrobiologjisë	Pulmologjisë	Kohë të pacaktuar	H8	1
4	Mjek specialist	Sëmundje Ngjitëse	Kohë të pacaktuar	H8	4
5	Mjek specialist	Neonatologji	Kohë të pacaktuar	H8	1
6	Mjek specialist	Radiologji	Kohë të pacaktuar	H8	4
7	Mjek specialist	Shërbimi i Mjekësisë Nukleare	Kohë të pacaktuar	H8	1
8	Mjek specialist i Radioterapisë	Onkologji	Kohë të pacaktuar	H8	1
9	Mjek specialist i Biokimisë Klinike	Biokimisë Mjekësore	Kohë të pacaktuar	H8	1
10	Mjek specialist	Oftalmologjisë	Kohë të pacaktuar	H8	4
11	Mjek specialist	Neurologji	Kohë të pacaktuar	H8	1
12	Defektolog	Otorinolaringologji	Kohë të pacaktuar	H15	1
13	Infermier/e baçelor	Klinika/Shërbimet e QKUK-së	Kohë të pacaktuar	H15	90
14	Mami/ baçelor	Klinika/Shërbimet e QKUK-së	Kohë të pacaktuar	H15	10

15	Infermier/e - shkollë e mesme	Klinika/Shërbimet e QKUK-së	Kohë të pacaktuar	H18	10
16	Laborant mjekësor baçelor	Klinika/Shërbimet e QKUK-së	Kohë të pacaktuar	H15	7
17	Teknik i radiologjisë baçelor	Radiologjia	Kohë të pacaktuar	H15	5
18	Fizioterapeut baçelor	Klinika/Shërbimet e QKUK-së	Kohë të pacaktuar	H15	4
19	Teknik-e i/e fizioterapisë	Klinika/Shërbimet e QKUK-së	Kohë të pacaktuar	H18	2
20	Bartës të pacientëve	Klinika/Shërbimet e QKUK-së	Kohë të pacaktuar	I21	22
				Gjithsej:	172

1. Titulli i punës: **Mjek Specialist në Klinika, Institute etj. në QKUK)**
Orari i punës: 40 orë në javë (orar të plotë)
Nëpunësi mbikëqyrës: Shefit të Repartit, Institutit të QKUK-së,

Qëllimi kryesor i vendit të punës: ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kuptimin cilësor e sasior bazuar në nivelin profesional që ka.

Përgjegjësit kryesore të mjekut specialist:

- Siguron standarde të larta të përkujdesjes ndaj pacienteve;
- Mirësjellja, kujdesi dhe respektimi i pacientit dhe personelit punues;
- Pranimi, ekzaminimi e trajtimi përkatës i pacientit;
- Kryen evidentimin e rregullt përmes dokumentacionit mjekësor (historia e sëmundjes, fletlëshimi, protokoli etj) të pacientit;
- Kryen vizitat e rregullta tek pacientët e shtrirë në institucionin shëndetësor;
- Bënë kërkesa për vizita plotësuese-konsultative;
- Mbikëqyrë realizimin e detyrave ditorë të punës të stafit punues;
- Jep mendime profesionale për punën që e kryen;
- Kryen detyra të tjera ashtu si kërkon mbikëqyrësi për mbarëvajtjen e punëve në institucionin ku është i punësuar;
- Është përgjegjës për hartimin e plan-programit të punës së tij individuale e kolektive në vendin e punës;
- Angazhon stafin punues në realizimin e detyrave ditore të punës;
- Siguron dhe zhvillon programe e kurse trajnimi profesional;
- Bën kontrollin e rregullt (inspektimin e hapësirave, pajisjeve dhe të inventarit në vendin e punës);
- Kujdeset për materialin shpenzues dhe pajisjet tjera;
- Siguron sistem efikas komunikimi për të gjithë brenda institucionit;
- Përpunon dhe realizon protokolle profesionale të trajtimit të pacienteve;
- Merr pjesë në studime kërkimore-shkencore profesionale;
- Ndërmerr masa për ngritjen e cilësive menaxhuese të aftësimi profesional dhe kolektiv në repart (njësi);
- Ushtron detyra plotësuese bazuar në kualifikimin e tij profesional dhe menaxhuese etj;
- Dhënia e këshillave profesionale me shkrim e me gojë rreth trajtimit të pacientit dhe përcaktimit të terapisë ditore;
- Përcakton radhën dhe planin e ekzaminimeve klinike-laboratorike;

- Sipas radhës punë në ambulancën për pacientët jashtë spitalor dhe bënë ekzaminimin-pranimin e tyre.

2. Titulli i punës:	Defektolog në Klinikën e Otorinolaringologjisë
Orari i punës:	40 orë në javë (orar të plotë)
Nëpunësi mbikëqyrës:	Shefit të Shërbimit të Logopedisë

Qëllimi kryesor i vendit të punës për Defektolog:

Qëllimi i punës së defektologut është mbështetja e zhvillimit të plotë të fëmijës dhe përmirësimi i cilësisë së jetës përmes ndërhyrjes edukativo-terapeutike.

Përgjegjësit kryesore të Defektologut:

- Defektologu merret me vlerësimin e foshnjeve dhe fëmijëve në zhvillim të hershëm të lindur me rrezik faktor dhe vlerësimin, edukimin dhe rehabilitimin e fëmijëve me vështirësi zhvillimore, përfshirë:
- Çrregullimet e të folurit dhe gjuhës,
- Çrregullimet neurologjike dhe motorike,
- Vështirësitë në të mësuar dhe zhvillimin kognitiv,
- Çrregullimet e shikimit dhe dëgjimit të dëmtuar,
- Si dhe me ndërhyrje të personalizuar për përmirësimin e aftësive komunikative, sociale dhe funksionale.

3. Titulli i punës:	Infermier/ë të përgjithshëm me Bachelor dhe Infermier/e Akusherike (Mami) me Bachelor
Orari i punës:	40 orë në javë (orar të plotë)
Nëpunësi mbikëqyrës:	Kryeinfermierit/res të Repartit, Institutit, Njesisë.

Qëllimi kryesor i vendit të punës: ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kuptimin cilësor e sasior, bazuar në nivelin profesional që kërkohet për të gjithë profesionistët shëndetësor.

Përshkrimi i punëve dhe fushat e përgjegjësisë për Infermierë të Përgjithshëm – Bachelor dhe Infermierë të Përgjithshëm – Shkolla mesme:

- Do të punojë si pjesëtar/e i/ e ekipit të kujdesit mjekësorë, në ofrimin e standardit me të lartë të kujdesit shëndetësor të përqendruar në pacientin, duke siguruar në çdo kohë kujdes të duhur dhe të sigurt për pacientët,
- Zbaton politikat integruese dhe udhëzimet organizative për standardet profesionale,
- Të zbatojë të gjitha aktivitetet profesionale specifike për profesionin dhe departamentin ku punon,
- Të caktojë, planifikojë, zbatojë dhe vlerësojë kujdesin ndaj të sëmurit në përputhje me politikën e aprovuar,
- Merr pjesë në zhvillimin profesional për të rritur / zhvilluar praktiken infermierive,
- Sipas nevojës t'i asistojë pacientit në mbajtje të higjienës personale, gjatë të ushqyerit, kryerjes së nevojave fiziologjike dhe aktiviteteve tjera që promovojnë shëndetin dhe mirëqenien e pacientit,
- Të kontribuojë në krijim të një mjedisi të sigurt klinik për të gjithë pacientët dhe kolegët,
- Të sigurojë komunikim të mirë gjatë dorëzimit të detyrës pas orarit të punës si dhe të dhëna të sakta për pacientët për të cilët është kujdesur gjatë tërë orarit të tij/ saj të punës,
- Të iu jap pacientëve informata të sakta dhe të qarta lidhur me kujdesin i cili iu ofrohet atyre,

- Të kontribuojë në mbajtje të pastërtisë dhe higjienës në mjedisin ku punon dhe të punoj gjithnjë në përputhje me udhëzuesit mbi kontrollin e infeksionit,
- Të administrojë terapinë e përshkruar në përputhje me politikën Institucionale,
- Të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për parandalim të dekubitit,
- Të përdor dhe të mirëmbajë në mënyrë të duhur dhe të sigurt të gjitha pajisjet,
- Të asistojë në hartimin e udhëzuesve procedurave të shkruara mbi punën e infermiereve,
- Të marrë pjesë në mbledhjet e ekipit kur ajo është e nevojshme,
- Të marrë pjesë në aktivitetet e organizuara sipas programeve për njësi të caktuara me qëllim të shkëmbimit të njohurive dhe informative në mes të personelit shëndetësor,
- Të ruajë konfidencialitet të plotë për çështjet që kanë të bëjnë me trajtimin e pacientit apo punën e institucionit, përveç në rastet kur ajo /ai autorizohet me shkrim, në përputhje me politikën Institucionale,
- Gjithnjë të veprojë në mënyrë të tillë, që do të ndihmonte në avancimin e marrëdhënieve të mira pacient - infermier/e,
- Të marrë pjesë në aktivitetet për edukimin e vazhdueshëm profesional në mënyrë që të freskojë dhe avancojë njohuritë dhe standardet e punës infermiereve,
- Të kryejë edhe detyra tjera që kërkojnë nga mbikëqyrësi për të siguruar efikasitet të lartë në punë,
- Punon dhe bashkëpunon me profesionistët tjerë shëndetësor duke përdorur mekanizmin për monitorimin e rezultatit të kujdesit ndaj pacientit,
- Lehtëson koordinimin e kujdesit për të arritur rezultatet e shëndetit,
- Zbaton protokollet e praktikave infermiere të bazuara në dëshmi, gjatë ofrimit të kujdesit infermior,
- Përdor dhe kontribuon në hulumtime që ndërlidhen me dëshmitë për siguri dhe praktikën efektive dhe eficiente.

4. Titulli i punës: Infermierë të përgjithshëm me Shkollë të Mesme

- Orari i punës: 40 orë në javë (orar të plotë)
- Nëpunësi mbikëqyrës: Kryeinfermierit/res të Repartit, Institutit, Njësisë.

Përshkrimi i punëve dhe fushat e përgjegjësisë për infermierë të përgjithshëm,
(Shkolla e Mesme):

- Do të punojë si pjesëtar/e i/ e ekipit të kujdesit mjekësorë, në ofrimin e standardit me të lartë të kujdesit shëndetësor të përqendruar në pacientin, duke siguruar në çdo kohë kujdes të duhur dhe të sigurt për pacientët.
- Të zbatojë të gjitha aktivitetet profesionale specifike për profesionin dhe departamentin ku punon.
- Të caktojë, planifikojë, zbatojë dhe vlerësojë kujdesin ndaj të sëmurit në përputhje me politikën e aprovuar.
- Të kolektojë të dhëna të sakta mbi pacientin sipas specifikave të infermierit/teknikut përgjegjës.
- Sipas nevojës t'i asistojë pacientit në mbajtje të higjienës personale, gjatë të ushqyerit, kryerjes së nevojave fiziologjike dhe aktiviteteve tjera që promovojnë shëndetin dhe mirëqenien e pacientit.
- Të kontribuojë në krijim të një mjedisi të sigurt klinik për të gjithë pacientët dhe kolegët.
- Të sigurojë komunikim të mirë gjatë dorëzimit të detyrës pas orarit të punës si dhe të dhëna të sakta për pacientët për të cilët është kujdesur gjatë tërë orarit të tij/ saj të punës.
- Të iu jap pacientëve informata të sakta dhe të qarta lidhur me kujdesin i cili iu ofrohet atyre.
- Të kontribuojë në mbajtje të pastërtisë dhe higjienës në mjedisin ku punon dhe të punoj gjithnjë në përputhje me udhëzuesit mbi kontrollin e infeksionit,
- Të administrojë terapinë e përshkruar në përputhje me politikën Institucionale,
- Të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për parandalim të dekubitit,
- Të përdor dhe të mirëmbajë në mënyrë të duhur dhe të sigurt të gjitha pajisjet,
- Të asistojë në hartimin e udhëzuesve procedurave të shkruara mbi punën e infermiereve.

- Të marrë pjesë në mbledhjet e ekipit kur ajo është e nevojshme,
- Të marrë pjesë në aktivitetet e organizuara sipas programeve për njësi të caktuara me qëllim të shkëmbimit të njohurive dhe informative në mes të personelit shëndetësor,
- Të ruajë kufidencialitetin të plotë për çështjet që kanë të bëjnë me trajtimin e pacientit apo punën e institucionit, përveç në rastet kur ajo /ai autorizohet me shkrim, në përputhje me politikën Institucionale,
- Gjithnjë të veprojë në mënyrë të tillë, që do të ndihmonte në avancimin e marrëdhënieve të mira pacient - infermier/e,
- Të marrë pjesë në aktivitetet për edukimin e vazhdueshëm profesional në mënyrë që të freskojë dhe avancojë njohuritë dhe standardet e punës infermierike,
- Të kryejë edhe detyra tjera që kërkojnë nga mbikëqyrësi për të siguruar efikasitetin të lartë në punë.

5. Titulli i punës:	Laborant mjekësor me Bachelor
Orari i punës:	40 orë në javë (orar të plotë)
Nëpunësi mbikëqyrës:	Kryelaborantit të Njesisë/Shërbimit

Përshkrimi i punëve dhe detyrave për Laborant Bachelor – drejtimi mjekësor:

- Laborantët do të punojnë si pjesëtar i ekipit të kujdesit mjekësor, në ofrimin e standardit më të lartë të kujdesit shëndetësor të përqendruar në pacientin, duke siguruar në çdo kohë kujdes të duhur dhe të sigurtë për pacientin,
- Varësisht nga testet që kryhen në laborator, të marrë, përgatisë, analizojë dhe asgjësojë në mënyrë të sigurtë të gjitha mostrat klinike,
- Të mbajë të dhëna të sakta mbi pacientet, ashtu si do të specifikohet nga infermieri/tekniku përgjegjës,
- Të kryejë të gjitha procedurat dhe detyrat e deleguara, në përputhje me politiken e aprovuar,
- Të kujdeset për një ambient të sigurtë për të gjithë pacientet dhe koleget,
- Të sigurojë një komunikim të mirë me personelin gjatë dorëzimit të detyrës në përfundim të orarit të punës, duke siguruar të dhëna të sakta mbi pacientet e trajtuar gjatë orarit të tij/saj të punës,
- Në rastet kur kjo është e mundur, t'u japë pacientëve informata të sakta dhe të qarta lidhur me kujdesin që iu ofrohet atyre,
- Të përdorë, mirëmbajë dhe ruajë në mënyrë të duhur dhe sigurtë të gjitha pajisjet,
- Të marrë pjesë në mbledhjet e ekipit klinik, kur trajtohen çështje relevante për këtë profil pune,
- Të marrë pjesë në programet e përpiluara për njësi të veçanta, me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe informatave me personelin infermierik,
- Të ruajë nivelin e standardit të punës profesionale dhe të punojnë në përputhje me Kodin e Mirësjelljes të Shoqatës Infermierike të Kosovës,
- Të ruajë konfidencialitetin absolut lidhur me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pacientin dhe spitalin, përveç në rastet kur kjo është aprovuar me shkrim, në përputhje me politiken spitalore,
- Gjithnjë, të veprojnë në atë mënyrë që do të ndikonte në promovimin e marrëdhënieve të mira pacient –infermier/e,
- Të marrë pjesë në aktivitete për zhvillimin e vazhdueshëm profesional, për të freskuar dhe avancuar njohuritë dhe standardet e punës profesionale.

6. Titulli i punës:	Teknikë të Radiologjisë me Bachelor
Orari i punës:	40 orë në javë (orar të plotë)
Nëpunësi mbikëqyrës:	Kryeteknikut të Njesisë

Përshkrimi i punëve dhe detyrave për Teknikë të Radiologjisë me Bachelor:

- * Tekniku i Radiologjisë më Bachelor do të punojë si pjesëtar i ekipit të kujdesit mjekësor, në ofrimin e standardit më të lartë të kujdesit shëndetësor të përqendruar në pacientin, duke siguruar në çdo kohë kujdes të duhur dhe të sigurtë për pacientin,
- Të sigurojë pastërtinë dhe higjienën e mjediseve klinike dhe gjithnjë t'u përmbahet udhëzueseve për kontrollin e infeksionit,
- Gjithnjë t'u përmbahet udhëzueseve mbi mbrojtjen radiologjike të pacienteve dhe personelit,
- Të kujdeset për një ambient të sigurtë për gjithë pacientet dhe koleget,
- Të menaxhojë mbeturinat në përputhje me politiken spitalore,
- Të administrojë terapinë e përshkruar në përputhje me politiken spitalore,
- Të marrë pjesë në planifikimin e kujdesit ndaj pacientit,
- Të marrë, shfrytëzojë, mirëmbaje dhe ruaje në mënyrë të sigurtë dhe të duhur të gjitha informatat dhe pajisjet.
- Të asistojë në hartimin e udhëzueseve të shkruar mbi procedurat klinike.
- Të asistojë në vlerësimin e efikasitetit të intervenimeve klinike
- Të mbledhë dhe raportojë mbi të dhënat e nevojshme, në përputhje me politiken spitalore
- Të marrë pjesë në mbledhjet e ekipit klinik, kur trajtohen çështje relevante për këtë profil pune,
- Të sigurojë që i gjithë stafi e ka mundësinë të shprehe mendimin dhe sugjerimet lidhur me përmirësimin e punës dhe mjedisit të punës,
- Të ruajë nivelin e standardit të punës profesionale dhe të punojë në përputhje me Kodin e Mirësjelljes të Shoqatës Infermierike të Kosovës,
- Të ruajë konfidencë absolute lidhur me të gjitha çështje që kanë të bëjnë me pacientin dhe spitalin, përveç se në raste kur kjo është aprovuar me shkrim, në përputhje me politiken spitalore,
- Gjithnjë, të veprojë në atë mënyrë që do të ndikonte në promovimin e marrëdhënieve të mira pacient – infermier/e,
- Të marrë pjesë në aktivitete për zhvillimin e vazhdueshëm profesional, me qëllim të freskimit dhe avancimit të njohurive dhe standardeve të punës profesionale.

7. Titulli i punës:	Fizioterapeut me Bachelor dhe me Shkollë të Mesme
Orari i punës:	40 orë në javë (orar të plotë)
Nëpunësi mbikëqyrës:	Krye fizioterapeutit të Repartit

Përshkrimi i punëve dhe fushat e përgjegjësisë për Fizioterapeut (më Bachelor dhe me Shkollë të Mesme):

- Fizioterapeuti Bachelor dhe ai më shkollë të mesme do të punojë si pjesëtar/e i/ e ekipit të kujdesit mjekësorë, në ofrimin e standardit më të lartë të kujdesit shëndetësor të përqendruar në pacientin, duke siguruar në çdo kohë kujdes të duhur dhe të sigurtë për pacientët;
- Ofron dhe udhëheq shërbimet e fizioterapisë ndaj pacientëve, përfshirë vlerësimin, trajnimin, planifikimin dhe realizimin e trajtimit dhe mbajtjen e dokumentacionit të nevojshëm;
- Ofron shërbimet e fizioterapisë ndaj pacientëve;
- Kryen ekzaminimet e pacientëve për të caktuar nevojën për intervenim / trajtim,
- Vlerëson pacientin me qëllim të marrjes së informata ve të nevojshme për planifikimin dhe realizimin e trajtimit,
- Kryen vlerësime specifike sipas indikacioneve dhe interpreton dhe komunikon të dhënat e vlerësimeve,
- Zhvillon planin e trajtimit sipas problemeve të identifikuara dhe përcakton qëllimet e trajtimit,
- Realizon trajtimin e paraparë në planin e trajtimit,
- Modifikon adapton trajtimin sipas indikacioneve për arritjen e qëllimeve,
- Jep këshilla dhe udhëzime për programin shtëpiak për mirëmbajtjen dhe rritjen e rezultateve të arritura gjatë trajtimit,

- Dokumenton rezultatet e vlerësimit, trajtimit, përcjelljes dhe përfundimit të trajtimit,
- Rekomandon marrjen dhe fabrikimin e pajisjeve ndihmëse ortoptikë ose protetike si dhe këshillon pacientët, familjarët dhe personelin tjetër për përdorimin dhe aplikimin e këtyre pajisjeve,
- Mbikëqyrë dhe udhëheq punën e teknikëve të fizioterapisë dhe personelit tjetër ndihmës në implementimin e planit të trajtimit,
- Komunikon në mënyrë formale dhe joformale me profesionistët tjerë në koordinimin e programit rehabilitues të pacientit,
- Merr përgjegjësi për aftësime të vazhdueshëm profesional dhe ngritje profesionale.
- I raporton dhe i përgjigjet Fizioterapeutit kryesor të Njesisë.

8. Titulli i punës: Bartës të pacientëve,
 Orari i punës: 40 orë në javë (orar të plotë)
 Nëpunësi mbikëqyrës: mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë.

Qëllimi i postit: Mbështetë stafin menaxhues në përmbushjen e aktiviteteve duke bërë mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për të krijuar raporte përmbledhëse në bazë të indikatorëve specifik.

Detyrat Kyçe:

- Bën bartjen e pacientëve në klinika, institucione;
- Bartjen e pacienteve prej klinike në Klinikë – shërbim etj;
- Bartjen e pacientëve sipas kërkesës së menaxhmentit të klinikës;
- Për punë i përshatet orarit të punës sipas legjislacionit në fuqi;
- Bartjen e pacientëve prej klinike deri në vendin e caktuar;
- Bartjen e pacientëve edhe punë të tjera sipas urdhrit të përgjegjës;
- Si dhe kryen detyra shtesë në pajtim me ligjislacionin në fuqi.

Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë, sipas nenit 9 të LZP-së

1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
2. Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
3. Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
4. Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
5. Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
6. Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
7. Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.
8. Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

Kërkesat e përgjithshme formale

- Arsimimi i kërkuar: Diplomë e Fakultetit të Mjekësisë – Specializimi, për pozitën me nr.1 deri 10; licencë valide e punës;
- Arsimimi i kërkuar: Diplomë në fushën e edukimit dhe rehabilitimit special/mastar për pozitën me nr.11; licencë valide e punës;
- Arsimimi i kërkuar: Diplomë bachelor në fushën e infermierisë për pozitën me nr. 12 dhe 13; licencë valide e punës;
- Arsimimi i kërkuar: diplomë e shkollës së mesme në fushën e infermierisë për pozitën me nr.14; licencë valide e punës;
- Arsimimi i kërkuar: Diplomë bachelor në fushën e radiologjisë/laborant dhe fizioterapi për pozitën nr.15,16 dhe 17; licencë valide e punës;

- Arsimimi i kërkuar: diplomë e shkollës së mesme të mjekësisë - drejtimi fizioterapi për pozitën nr.18; licencë valide e punës;
- Arsimimi i kërkuar: diplomë e shkollës së mesme - drejtimi jo mjekësor për pozitën nr.19.

Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- Njohuri në fushën profesionale specifike;
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë;
- Njohuri të gjëra të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;
- Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.
- Njohja e gjuhëve të huaj (e preferueshme).

Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre:

- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës;
- Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës;
- Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë;

Dëshmitë që nuk kërkohen gjatë aplikimit, por në fazën e verifikimit para emërimit

- Certifikatë mbi dënimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata përmes së cilës dëshmohet se nuk është i/e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më të vjetër se (6) muaj nga data e lëshimit;
- Dëshmi se kandidati është i aftë në pikëpamje shëndetësore;
- Dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar;
- Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (Kandidatet që janë të punësuar apo kanë qenë të punësuar në institucione publike);
- Diploma/licenca e noterizuar.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat si dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave sipas këtij konkursi.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar që i plotësojnë kriteret e konkursit.

Hapja e procedurës së konkurrimit shpallet nga NJBNJ në ueb faqen e konkurrimeve të SHSKUK dhe në tabelën e shpalljeve në QKUK, ndërsa pranimi i aplikacioneve për pozitën nën nr. rendor 1 – 19, behën në Sektorin e Personelit në QKUK, 30 ditë nga data e publikimit në SIMBNJ dhe në ueb faqen e SHSKUK-së, (10.11.2025 – 09.12.2025).

Për pozita me nr. rendor 19, data e mbylljes së konkursit: Njoftimi në SIMBNJ 15 ditë nga dita e publikimit më datë **10.11.2025**, dorëzimi i aplikacioneve në Sektorin e Personelit të QKUK-së bëhet brenda 15 ditëve vetëm për nr. rendor 19, aplikacioni pranohet deri më datë **24.11.2025**.

Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ të QKUK-së, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga komisioni përzgjedhës, vlerësimi nga nr. rendor 1 - 18 bëhet nëpërmjet një testimi me shkrim për vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale dhe një interviste me gojë, ndërsa për nr. rendor 19 bëhet vetëm një intervistimi (Pozita e fundit nuk do të ketë test me shkrim).

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet shkarkohen nga ueb faqe të SHSKUK-së në linkun e publikimit, plotësohet në mënyrë elektronike dhe së bashku me dokumentacionin e kërkuar me konkurs komplet dorëzohen në Sektorin e Personelit të QKUK-së.

Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës (Nr. rendor i sektorit ku ju aplikoni psh.1, 2, e deri më 19). Të gjitha dokumentet dhe dëshmitë profesionale t'i bashkëngjiten aplikacionit.

Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Kandidatët të cilët aplikojnë të ofrojnë dëshmi sipas konkursit të shpallur, për ndryshe kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të thirren për testin me shkrim.

Dokumentacioni i bashkangjitur këtij aplikimi nuk kthehet.

Originalin e dokumenteve të noterizuara dhe Certifikata mjekësore origjinal do ta sjellin vetëm kandidatët e pranuar atëherë kur thirren për nënshkrim të kontratës për të gjitha pozitat.

Ky Konkurs publik është me karakter vjetor, prandaj stafi që do të përzgjidhet do të ftohet në punë në përputhje me mundësitë buxhetore për vitin 2026.



Sektorit i Personelit të QKUK-së